

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e Prokurimit Komuna e Gjilanit	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Agim Sheqiri – Ekspert Shqyrtues i prokurimit.		
Lënda:	Raporti i Ekspertit Shqyrtues, lidhur me ankesën me Nr.207/2019 të parashtruar nga OE.”Pastor Kosova” shpk		
Datë	22.05.2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin lidhur me ankesën e datës 10.05. 2019 me nr. 207/19 të parashtruar nga OE.” Pastor Kosova ” shpk për aktivitetin e prokurimit: “*Furnizim me Ekstrat per formimin e shkumes per NJPZSH*” me nr. i prokurimit 651-19-1352-1-3-6 i udhëhequr nga Komuna e Gjilanit

AK, është i thirrur që pas marrjes së raportit të Ekspertit Shqyrtues lidhur me këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.


Të bashkangjitur gjeni raportin e Ekspertit Shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- OE ankues
- Autoritetit Kontraktues- **Komuna e Gjilanit**
- Panelit Shqyrtues – OSHP



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

		14.05 .2019	22.05.2019
Nënshkrimi i ekspertit		data e autorizimit të ekspertit.	data e dorëzimit të raportit

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën: 10.05.2019 OE. “*Pastor Kosova*” parashtron ankese në OSHP për aktivitetin e prokurimit: për aktivitetin e prokurimit: “**Furnizim me ekstrat per formimin e shkumes per NJPZSH**” me nr. i prokurimit **651-19-1352-1-3-6** i udhëhequr nga *Komuna e Gjilanit*

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Operatori Ekonomik Ankues “*Pastor Kosova*” Prishtinë

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Nenet: 7, 56, 59, 60

5. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Vendimi i AK për eliminim, me arsyetim: Pas hulumtimit ne treg dhe sipas ofertave kemi vërejtur se ju keni ofertuar me çmim te larte për liter 11.62 euro ndërsa çmimi ne treg është 4.50 deri ne 6 euro me TVSH- NUK QENDRON.

Arsyetim

Faktet e dhëna nga AK për arsyet e eliminimit nuk qëndrojnë, janë të pabaza absolutisht.

Çmimi i dhëne në ofertë nga *Pastor Kosova* është çmim real i tregut për artikullin e përcaktuar ne DT. Kjo ka qene një shpallje publike ku kane mundur te ofertojnë edhe ofertues tjerë, nuk është se vetëm ne prodhojmë apo shesim këtë artikull.

Varësisht nga prodhuesi dhe kualiteti i produktit, sigurisht që ndryshon edhe çmimi në treg. Çmimi në të cilin thirret AK (6 euro) është minimum çmimi i furnizimit.

Në treg mund të ketë prodhime të ndryshme dhe me çmime të ndryshme, varësisht nga prodhuesi dhe përbërja e shkumës (në treg, ka tipe të ndryshme ekstraktit të shkumës dhe me çmime të ndryshme, në varësi nga % e përzierjes.

Në kemi ofruar produktin e prodhuesit të mirënjohur ORCHIDE nga Gjermania, që në raport me kualitetin dhe % e përzierjes të produktit ka edhe koston. Ndërsa një ndryshim të vogël në çmim mund të rezultojë se në këtë rast në DT është kërkuar sasi e vogël (300 litër), që edhe prodhuesi ka çmim tjetër, shpenzimet e transportit, administrative, etj. janë më të larta.

Zakonisht ky artikull nga konsumatorët (Njësite zjarrfikëse, etj.) blihet në sasi shumë më të mëdha (5000L, 10000L edhe më shumë) sepse si e tillë është edhe e nevojshme që të disponojnë brigadat zjarrfikëse me rezerva të tilla, e që në sasi më të mëdha, normalisht që edhe çmimi mund të jetë më i ulët.

Oferta e jone ka qene brenda buxhetit te parapare nga AK
Oferta 3,486.00 Euro, ndërsa buxheti i planifikuar nga AK 4000.00 Euro
Pastor Kosova ka plotësuar kushtet e përcaktuara në DT nga AK

Dëmet materiale

Oferta e Pastor Kosova është e përgjegjshme, andaj kërkojmë që lënda të kthehet në RIVLERESIM dhe të vendoset si në dispozitiv.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë:	20.03.2019
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	Kontratë për furnizim me vlerë të vogël.
Vlera e parashikuar e kontratës:	4,000.00 €
Kriteri për dhënie të kontratës(N.52):	tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave.	27.03.2019

Data e hapjes së ofertave 27.03.2019

Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave 25.04.2019

Data e kërkesës për rishqyrtim..... me datë
26.04.2019 është parashtruar kërkesa për rishqyrtim, po ashtu me datë 30.04.2019 AK nxjerr
vendim dhe refuzohet kërkesa për rishqyrtim .

Kriteret për kualifikim:

II.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

1. Kërkesa OE duhet të përmbush kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP) , Ligji nr. 04 L-42.LPP mund shkarkohet nga <http://krpp.rks.net> a.1. Deklaratë nën betim - Operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjin Nr. 04 L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 05 L - 092, Neni 65 , siç është e cekur në Pjesën , të Aneksit 1,
2. b. Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit, të OE në fjale nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para dorëzimit të tenderit.
3. Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush “Kërkesat e përshtatshmërisë”- të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Deklaratë nën betim - Operatori ekonomik duhet të përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr. 04 L-042, Neni 65 duke përdorur formën në Aneksin 1. (origjinali)
Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit, të OE në fjale nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para dorëzimit të tenderit- kërkohet kopje
Vërtetimin nga Gjykata Themelore-Departamenti për Çështje Ekonomike (kërkohet origjinal ose i vërtetuar noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit). Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshme risë pika 2 dhe 3 do të kërkohen nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t’ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit të këtij dokumenti, tenderi - O.E. do të konsiderohet si i pa përgjegjshëm, oferta do të refuzohet dhe do të vazhdohet me O.E. të dytë e kështu me radhë.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale

- 1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo Regjistrin e

ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit

2.Regjistrimi i TVSH;

3.Certifikata e numrit fiskal – kopje

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

-Certifikata e regjistrimit të biznesit – kopje

-Certifikata e TVSH – kopje

-Certifikata e numrit fiskal – kopje Nëse në Certifikatën e Regjistrimit të biznesit është i shënuar edhe numri fiskal atëherë Certifikata e Regjistrimit të Biznesit shërben edhe si dëshmi e Certifikatës.

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

N/A

I

II.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

N/A.

Raporti i hapjes publike të ofertave

Nr rend.	Operatori ekonomik	Vendi	Çmimi i ofertës në Euro
1.	“Pastor Kosova” Shpk	Prishtinë	3,486.90

Raporti i komisionit vlerësues

Komisioni vlerësues përkatësisht Autoriteti Kontraktues e anulon aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se çmimi i ofruar konsiderohet i lartë pasi që çmimet në treg sillen nga 4.5 deri në 6 Euro, ndërsa çmimi i ofertës është 11,62 Euro që konsiderohet çmim jashtëzakonisht i lartë për njësi.

Përgjigjeje në pretendimet ankimore të Operatorëve Ekonomik ankues :

Sqarim Hyrës:

Autoriteti Kontraktues lidhur me kërkesën për rishqyrtim ka nxjerr vendim në përputhje me nenin 108/A, dhe e ka refuzuar ankesën e OE ankues si të pa bazuar pasi që konsideron se çmimi i ofruar konsiderohet i lartë .

I pa kënaqur me përgjigjen lidhur me Kërkesën për Rishqyrtim OE.”Pastor Kosova” shpk parashtron ankesë në OSHP për shkelje të dispozitave të LPP-së të lartë cekura në ankesë.

Përgjigjeje në pretendimet ankimore

Eksperti Shqyrtues konstaton se pretendimi ankimor është i bazuar për faktin se AK sipas njoftimit për kontratë dhe në dosje të tenderit ka parare vlerë të parafet me ofertën e OE. “Pastor Kosova “ i cili ishte i vetmi ofertues.

Operatori ekonomik ankues çmimi e lartë e arsyeton me kualitetin e produkti të ofruar dhe se konsideron se çmimi është i arsyeshëm karshi kualitetit.

Shkeljet e konstatuara të LPP-së

AK gjatë zbatimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk e ka anuluar në përputhje me kërkesat e nenit 62 të LPP-së

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimin e lartë cekur , Eksperti Shqyrtues i rekomandon Autoritetit Kontraktues që të rivlerësohet aktiviteti i prokurimit pasi pretendimet ankimore të ngritura nga OE ankues lidhur me anulimin e procedurës së prokurimit i konsideron të bazuara.